

PËRKTHIMI I TEKSTEVE ME NDIHMËN E "GOOGLE TRANSLATE"

Zurijeta SALIU¹

¹Magjistër i Gjuhës dhe letërsisë shqipe

²zurijeta_saliu@live.com

Përmbledhje

Zhvillimi i hovshëm i teknologjisë dhe digjitalizimit ka ndikuar në çdo fushë, duke përfshirë edhe fushën gjuhësore, sepse gjuha është element kryesor për komunikim. Funksionimi i Internetit as që mund të paramendohet pa gjuhën, por edhe gjuha është e ndikuar mjaft nga Interneti, prandaj mund të themi se midis tyre ekziston një lidhje shumë e ngushtë. Hapësira e Internetit është bërë dhe një medium tjetër për përdorimin e gjuhës. Ky zhvillim ka bërë edhe më të lehtë jetën e njerëzve, sepse mund që më shpëjt të kryejnë detyra të ndryshme me anë të Internetit dhe risive teknologjike, se sa në forma tjera. Por nuk do të thotë se edhe zhvillimi i teknologjive dhe veçanërisht Interneti janë të përsosur dhe mund të bëjnë gjithçka.

Në këtë punim do të shohim përkthimin e teksteve në programin "google translate", ndihmën që na jep ky program, lehtësimin për të përkthyer nga një gjuhë në gjuhën tjetër dhe mangësitë që i ka ky program. Sa janë të sakta fjalët e përkthyer, sa janë të kuptueshme, sa e humbin kuptimin dhe sa nuk mund të përkthehen aspak. Në punimin në fjalë do të vërejmë përkthimin e disa fjalive nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, një gjuhë e njohur në të gjithë botën dhe nga gjuha shqipe në gjuhën maqedonase, gjuhën me të cilën jemi në kontakt në jetën e përditshme.

Fjalët kyçe: *gjuha, komunikim, internet, përkthim dhe fjalë.*

Abstract

The rapid development of technology and digitalization has influenced every field including the language field, because language is a key element of communication. The functioning of the Internet cannot be imagined without the language, but the language is also heavily influenced by the Internet, so we can say that there is a very close connection between them. The Internet has become another medium for the use of language. This development has made people's lives easier because they can more easily perform various tasks through the internet and technological innovations than in other forms. But that does not mean that the development of technologies and especially the Internet are perfect and can do everything.

In this paper we will look at the translation of texts into the "google translate", the help this application provides and the ease of translating from one language to another and the shortcomings it has. How accurate the translated words are, how understandable they are, how much they lose meaning and how much they can't translate at all. In this paper we will note the translation of some sentences from English into Albanian, a worldwide recognized language and from Albanian into Macedonian, the language we are in contact with in everyday life.

Keywords: *language, communication, internet, translation and words.*

Hyrje

Gjuha ka vlerën më të lartë në çdo vend dhe gjithkunj përdoret, sepse është një mjet shumë i rëndësishëm i komunikimit dhe me risitë teknologjike në fushën e komunikimit, e kanë përmirësuar komunikimin dhe ndërveprimin shoqëror midis njerëzve, duke mundësuar jo vetëm bartjen e informacioneve nga njëri skaj i botës në tjetrin, por edhe bartjen e botëkuptimeve, vlerave e koncepteve të reja. Gjuha është mjet themelor më i përsosur për komunikim mes njerëzve. Ajo mund të materializohet në dy mënyra: me të folur dhe me të shkruar. (Hamiti, 2006, p. 2). Në zhvillimet teknologjike në fushën e komunikimit më tepër përdoret gjuha e shkruar se sa gjuha e folur.

Pas vitit 1992, Interneti pati një përhapje dhe shtrirje marramendëse nëpër botë, duke u zhvilluar dhe përsosur edhe më tepër. Funksionet e tij u zgjeruan, duke mundësuar shkëmbimin e informatave dhe komunikimin në të gjitha format. Sistemet e ueb faqeve, të email-ve, të bashkëbisedimit në grupe dhe veç e veç (chat), sistemet e mesazheve të çastit (instant messenger) etj. (Munishi, 2009). Funksionimi i Internetit as që mund të paramendohet pa gjuhën, por edhe gjuha është e ndikuar mjaft nga Interneti, prandaj mund të themi se midis tyre ekziston një lidhje shumë e ngushtë. Hapësira e Internetit është bërë dhe një medium tjetër për përdorimin e gjuhës. Me zhvillimin e teknologjisë, sidomos me paraqitjen e internetit (Ibrahimi, 133:2012) Interneti ka ndikuar në ndryshimin e shumë gjuhëve të botës, ku hyn edhe gjuha shqipe.

Interneti, gjithashtu, i ka dhënë gjuhës varietete të reja stilistike, duke rritur gamën shprehëse të gjuhës në fundin joformal. (Linguasocio, 2009). Në këtë punim do të shohim përkthimin e teksteve në programin “*google translate*”, ndihmën që na jep ky program dhe lehtësimin për të përkthyer nga një gjuhë në gjuhën tjetër dhe mangësitë që i ka ky program. Sa janë të sakta fjalët e përkthya, sa janë të kuptueshme, sa e humbin kuptimin dhe sa nuk mund të përkthehen aspak. Në punimin në fjalë do të vërejmë përkthimin e disa fjalive nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, një gjuhë e njohur në të gjithë botën dhe nga gjuha shqipe në gjuhën maqedonase, gjuhën që kemi kontakt në jetën e përditshme. Si programi “*google translate*” ka edhe shumë programe të tjera që ndihmjnë për të përkthyer, që ta lehtësojnë punën, por në këto programe duhet shumë të punohet, në këto fusha ka shumë mangësi dhe duhet që tu jepet më tepër rëndësi që të vijë deri te përsosshmëria e këtyre programe.

SHËRBIMET E “GOOGLE TRANSLATE”

“Google translate” është një program që ndihmon për përkthim në disa gjuhë të ndryshme, në këtë program bëjnë pjesë 66 gjuhë, d.m.th. përkthimi mund të bëhet në mes këtyre 66 që bëjnë pjesë në këtë program.

Teksti i përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe me ndihmën e “google translate”

Në “*google translate*” bën pjesë edhe gjuha shqipe dhe do të shohim disa fjali se si janë të përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe.

Dukja e tekstit original në gjuhën angleze, ky tekst është një tekst i marrë nga një postë elektronike e pranuar dhe shkruar “The Editorial Board of ANGLISTICUM - International Journal of Literature, Linguistics & Interdisciplinary Studies invites submissions for Volume II, Issue No. 1, February 2013.

The submissions to the Journal are selected for publications on the basis of a peer-review mechanism conducted through an external Article Review Board consisting of academicians and experts in the fields covered by the journal.

Authors are invited to send their full article drafts at the e-mail address: anglisticum@gmail.com or by uploading directly at the "Submit your Papers" category at http://www.anglisticum.mk/submit_paper.php

The deadline for submissions is 31st of January 2013.

Submission received after this date shall be considered for the next volume in April 2013.

The guidelines for submission are available at our website in Journal Regulations at http://www.anglisticum.mk/submit_paper.php"

Përkthimi në gjuhën shqipe "Bordi Editorial i ANGLISTICUM - International Journal në Gjuhësi, Letërsi dhe Studime Ndërdisciplinore fton aplikime për Vëllimi II, çështja nr 1, shkurt 2013.

Parashtresat në Fletoren janë zgjedhur për botime mbi bazën e një mekanizmi për shqyrtim i kryer nëpërmjet një Bordin Shqyrtues të jashtëm nenin që përbëhet nga akademikë dhe ekspertë në fushat e mbuluara nga ditar.

Autorët janë të ftuar të dërgojnë draftet e tyre të plotë artikull në adresën e-mail: anglisticum@gmail.com ose nga ngarkimi direkt në "Submit" letrat tuaja në kategorinë http://www.anglisticum.mk/submit_paper.php.

Afati i fundit për aplikimet është 31 janar 2013.

Dorëzimi marrë pas kësaj date do të konsiderohet për vëllimin e ardhshëm në prill 2013.

Udhëzimet për paraqitjen janë në dispozicion në faqen tonë të internetit në Rregulloret Journal në http://www.anglisticum.mk/submit_paper.php."

Në këtë tekst vërejmë se disa fjalë janë të plota, të kuptueshme, disa fjalë ndërkombëtare nuk janë të shqipëruara, p.sh. International, në gjuhën shqipe "internacionale".

Poashtu edhe shumë fjalë nuk janë aspakt të përkthya, por mbeten në gjuhën angleze, në këtë tekst konkretisht kemi fjalët *Journal* dhe *draft*, por ka edhe shumë e shumë fjalë të tjera. Fjal "Journal" në shqip mund ta kemi si revistë, gazetë, libër shënimesh etj. kurse në tekstin e mësipërm dikun është përkthyer si fletore, ditar dhe fjala "draft" plan ose skicë.

Edhe pse përkthimi është i kuptueshëm, prapseprap ka gabime, sidomos në lidhjet sintaksore, fjalitë nuk janë të lidhura si duhet dhe në bazë të rregullave sintaksore.

Google translate është një program i dobishëm dhe ndihmon shumë, sepse shumë shpejtë mund të bëhet përkthimi i një teksti apo i një fjalie, vetëm se ajo nuk duhet të ngelet ashtu, por duhet që edhe pak të analizohet dhe ti jepet një kuptim i plotë teksit.

Disa shembuj nga gjuha shqipe në gjuhën maqedonase të përkthyer nëpërmjet "google translate"

Në vazhdim do të shohim disa shembuj nga gjuha shqipe të përkthyer në gjuhën maqedonase.

Shqip

Nuk mund të mësohet vetëm nëpërmjet shkrimit e leximit.

Të gjith shokët ishin kundër Sarës e Yllkës.

Babai shkoi pas djalit e vajzës.

E pashë rreth oborit e shtëpisë.

Ata shkuan mbas Besës e Lindës.

Blerta ndryshon në sjellje dhe veshje.

Unë bazohem në argumentet dhe faktet që i pashë.

Sara e Arta rrinë bashkë në shkollë e shtëpi.

Jeta ndihmon në renditjen dhe zbulimin e balonave.

Maqedonisht

Има само може да се научи преку пишување и читање.

Сите пријатели беа против Сара Yllkës.

Девојка отиде по татко на момчето.

Го видов околу дворот на куќата

Одеа по ветувањето на Линда.

Влerta промени во однесувањето и фустан.

Јас базохем на аргументи и факти што видов.

Sara Златен држат заедно во домот на училиште.

Живот помага пласман декорација на балони.

Nga shembujt e mësipër vërejmë se deri diku përkthimi është i kuptueshëm, por me mjaftë gabime. Në fillim duhet të theksojmë se disa emra të njerëzve kanë ngelur me shkronja të alfabetit shqip dhe nuk janë shëndruar në alfanbetin e gjuhës maqedonase.

Shumivca e emrava të personave që kanë kuptim në gjuhën shipe në qoftë se janë në fillim të fjalisë apo pas një emri tjetër përkthehen në gjuhën maqedonase, kurse në qofte se janë në mes të fjlisë, atëherë ngelen si emër personi. P.sh. Arta, Besimi, Linda, Lulja etj.

Sa u përket numrave, përkthimi i numrave është në rregull, qofshin ato të shkruar me numra apo me shkronja.

Në lidhjen e fjalive në të shumtën e rasteve mungon lidheza “dhe”.

Fjalitë shpesh e humbin kuptimin, edhe pse fojlet janë të përkthyer në rregull, por me ndrymin e vendeve të fjalëve në fjali, fjalia e humb kuptimin, edhe pse të gjithë fjalët janë prezente nuk janë të radhitura si duhet dhe e njëjta gjë ndosh si te përkthimin nga anglishtja në shqip ku mungon rregulla e lidhjes sintaksore.

Përfundim

Në këtë punim kemi vërejtur diçka dhe jo gjithçka, është një punim shumë i gjërë dhe nuk mjafton vetëm kjo, por jam munduar që të shoh disa gjëra që janë të dobishme për gjuhën nga Interneti.

Më sipër vërejtëm se programi i njohur “*google translate*” ndihmon për përkthimin e teksteve dhe të jep një lehtësi të madhe, me anë të këtij perogrami shumë lehtë mund të përkthehen tekstet, përveç këtij program ka edhe programe të tjera, por në këtë punim jemi bazuar në këtë program.

Me qenë se thamë se ky program ndihmon shumë në përkthimin e teksteve, këtu kemi edhe disa mangësi, si pasojë e punës së paktë që është bërë në lidhje me këtë fushë sa i përket gjuhës shqipe.

Duke u bazuar në këtë punim mund të shohim shërbimet që na jep ky program:

1. Përkthimi i teksteve bëhet shumë shpëjtë;
2. Tekstet e përkthyer janë të kuptueshme;
3. Numra përkthehen pa asnjë problem etj.

Me qenë se ky program na ofron shumë shërbime, gjithashtu ka edhe disa mangësi të cilat janë:

1. Shumë fjalë nuk përkthehen aspak prej një gjuhe në një gjuhë tjetër;
2. Disa fjalë në fjali nuk përkthehen, por nëse i ndan nga fjali, vetëm si një fjalë atëherë përkthehen;
3. Disa emra të njerëzve që janë emra shqip (si p.sh. Lulja, Arta, Besimi etj.) nëse nuk janë në fillim të fjalisë ose pas një emri tjetër atëherë marim formën e foljes dhe kalojnë në gjuhën që e ke kërkuar përkthimin;
4. Shpesh ndodh që fjalitë ta humbin kuptimin, edhe pse të gjitha fjalët janë në fjali, por mungon rregula e lidhjeve sintaksore;
5. Lidhëzat shpesh mungojnë dhe fjalia e përkthyer mbate pa lidhëza etj.

Këto ishin disa elemente kryesore sa i përket këtij punimi dhe Interneti ka ndikuar shumë në gjuhë. Sa më tepër që të punohet nëpër këto fusha, aq më tepër njerëzve do t'ua lehtësoj punët dhe gjërat do të jenë më të qarta dhe më të lehta në çdo punë dhe çdo fushë.

Literatura

- [1]. Çepani, Anila. (2006). *Probleme të kulturës së gjuhës në përdorimin e shqipes në internet*. Në Seminari XXV Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, nr. 25/1. Prishtinë.
- [2]. Ibrahim, Mustafa. (2012). *Tema sociolinguistike*. Interlingua. Shkup.
- [3]. Munishi, Shkumbin. (2009). *Gjuha shqipe dhe interneti*. Në "Filologji", nr. 16. Prishtinë.
- [4]. Hamiti M. & Ibrahim M. (2006). "Denduria e përdorimit të fonemave zanore e bashkëtingëllore në tekstet e botuara shqipe në Maqedoni". Tetovë.

Material të shkarkuara nga interneti:

- [1]. <http://linguasocio.blogspot.com/2009/05/gjuha-shqipe-dhe-interneti.html>
- [2]. <http://translate.google.com/>